



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 7.3.2025

Nr: 248

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
KUÇOVË, PËR PERIUdhËN 23 SHKURT-1 MARS 2025**

Sot, më datë 7.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

SUBJEKT: Bashkia Kuçovë

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Kuçovë, për periudhën 23 shkurt- 1 mars 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 23 shkurt- 1 mars 2025, Bashkia Kuçovë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- “Inspektim i vazhdimit të punimeve ne rrugën Goraj – Sheqëz”, raportuar në datë 28.2.2025 për t’u zhvilluar në datë 4.3.2025

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Kuçovë një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Data: 7.3.2025 Nr. 248
Ora:18:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Kuçovë, për periudhën 23 shkurt-1 mars 2025”

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Kuçovë ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Nga ana e personit përgjegjës për raportimet, është kryer një gabim njerëzor gjatë hedhjes së të dhënave sepse gabimisht mendoj se muaj shkurt këtë vit ishte me 29 ditë dhe jo 28 ditë. Lutemi të mirëkuptohet situata nga ana juaj. Ky gabim nuk është kryer për tu shmangur rregullave dhe ligjit zgjedhor. Për këtë arsye, aktiviteti “Inspektim i vazhdimit të punimeve ne rrugën Goraj – Sheqëz” u anulua dhe nuk u zhvillua. Veprimtaria është riraportuar nga ana e Bashkisë Kuçovë në datë 04.03.2025, për t’u zhvilluar më datë 10.3.2025, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji”.*

Referuar pretendimeve të dhëna dhe hetimeve të kryera nga ana e KQZ, konstatohet se është kryer një gabim gjatë hedhjes së të dhënave në ndërfaqe, pasi ka marrë shënimin si “e ndaluar” në NRI, veprimtaria nuk është zhvilluar. Pas verifikimeve të kryera në NRI, veprimtaria është riraportuar duke respektuar afatin ligjor. Në këto kushte, mirëkuptohet situata dhe nuk jemi para rrethanave të një kundërvajtje administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Kuçovë.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI